

EMINE ARIFI-BAKALLI

**“KRYENGRITJA E FIERIT” SI SHKAS I KTHESËS NEGATIVE
NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-JUGOSLLAVE**

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave duke filluar me negociatat dypalëshe (fund 1933-maj 1934) për Marrëveshjen Plotësuese për Tregti e Lundrim të vitit 1926 dhe të tjerave të kësaj natyre,¹ shënuan kthesë pozitive dhe nga të dy palët cilësoheshin si miqësore. Edhe pse realizimi i këtyre marrëveshjeje po zvarritej dhe praktikisht po mungonin rezultatet e pritura, pala shqiptare deri me rastin e “Kryengritjes së Fierit” nuk rreshti së shpresuari se përpjekjet e saj për emancipim ekonomik dhe politik do të gjenin mbështetje konkrete nga Jugosllavia që nënkuptonte edhe përkrahjen nga aleatët e saj perëndimorë e ballkanikë dhe nga vetë Pakti Ballkanik. Por, pozicionimi jugosllav ndaj kësaj ngjarjeje dhe reaksioni shqiptar në këtë rast praktikisht shënon heqjen dorë nga iluzioni për partneritet e miqësi midis këtyre dy shteteve fqinjë.

Ndërkaq as historianët shqiptarë² dhe as ata të huaj që u morën me rrjedhat politike në shtetin shqiptar, me pozitën e tij ndërkombëtare po dhe me marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave³, nuk kanë arritur të shohin

¹ Për këtë shih: Emine Arifi-Bakalli, *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave (1929-1939)*, Instituti i Historisë-Kosovë, Prishtinë: 1997.

² Historiografia shqiptare në përgjithësi ngjarjen e Fierit e ka përkufizuar si “kryengritja e Fierit” dhe si veprim të fundit revolucionar të rretheve demokratike borgjeze kundër “regjimit zogist”. Mentar Belegu, *Kryengritja antizogiste e Fierit*, Universiteti i Tiranës “Enver Hoxha”, Tiranë: 1987; Arben Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: Toena, 2009, f. 535-538; Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, vëll. I (1912-1939), Tiranë: Toena, 2013, f. 841-842; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, *Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939*, Tiranë: Toena, 2007, f. 323-325 etj.

³ Indro Montanelli, *Shqipëria një dhe njëmijë*, Tiranë: Uegen 2004, f. 116; Antonello Biagini, *Historia e Shqipërisë*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit 2000, f. 164; Bernd Fisher, *Përpjekjet e Mbretit Zog për stabilitet*, Tiranë: Botimet Çabej, 1997, f. 255-257; Nina Smirnova, *Histori e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë: Ideart, 2004, f. 182-190; Živko Avramovski, “Prilog pitanju istorije Albanije u periodu izmedju dva svetska rata”, në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 3, Prishtinë: 1966; Vuk Vinaver, “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy Luftërave Botërore”, në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 1, Prishtinë: 1968 etj.

rolin e kësaj ngjarjeje në kthesën negative deri në tensionim të këtyre marrëdhënieve dhe faktin se kjo ngjarje nuk ishte e shkëputur nga zhvillimet e përgjithshme në planin rajonal dhe atë evropian.

Disa fjalë për ngjarjen

Më 14 gusht 1935, qyteza shqiptare - Fieri u bë epiqendër e një ngjarjeje, e cila pati jehonë të madhe, jo vetëm në Ballkan po dhe në Evropë. Tellalli i qytetës po e lajmëronte popullsinë e Fierit (ditë pazari), se Shqipëria ishte çuar në këmbë për rrëzimin e regjimit të Zogut dhe po theksonte se tashmë bashkëpunëtorët e afërm të tij si Krosi, Juka dhe Aranitasi e kishin paguar me kokë...⁴. Në Fier u burgos nënprefekti, i cili e kundërshtoi bashkëpunimin me kryengritësit, u organizua mitingu popullor dhe ra viktima e parë gjeneral Gjilardi⁵, i cili po kalonte nëpër qytet në fjalë. Aktorët kryesorë të kësaj ngjarjeje ishin intelektualit i formuar në ShBA- ish nënkryetar i Këshillit të Shtetit, Kostë Çekrezi⁶ dhe komandanti i xhandarmërisë në detyrë, Mustafa Kranja.

Në fakt, bartëse e kësaj lëvizjeje ishte Dega e Fierit e Organizatës së Fshehtë politike e themeluar në pranverë të vitit 1934*. Kjo organizatë për dallim nga ajo e vitit 1932 me të njëjtin emër, pati shtrirje në tërë Shqipërinë dhe brenda saj u përfshinë kategori të ndryshme shoqërore dhe politike, si: intelektualë, nacionalistë, bejlerë, komunistë, antizogistë,

⁴ *Arhiv Jugosllavije* (më tej: *AJ*), Centralni Pres Biro (më tej: CPB) (38-21-62), nr. 5767, Tiranë, 21 gusht 1935. Analizë e atasheut jugosllav për shtyp në Tiranë: Në fakt këtë informatë të rreme e kishte bërë vetë Çekrezi në fjalimin e tij të rastit. Sipas gazetës "Politika" (Beograd) (21 gusht 1935, f. 3), pas vrasjes së Gjilardit, Çekrezi i ishte drejtuar masës me fjalët: "Shikojeni Gjeneral Gjilardin e vrarë, kështu dënohen shërbëtorët e regjimit. Në të njëjtën kohë janë të shtrirë në pluhur dhe të vrarë Juka, Krosi, Dibra dhe armiq tjerë të popullit..."

⁵ *AJ*, CPB, (38-21-62), nr. 116, Tiranë, 21 gusht 1935. Analizë e atasheut jugosllav për shtyp në Tiranë.

⁶ A. Çekrezi sapo i liruar nga burgu (i dënuar si pjesëmarrës i lëvizjes antizogiste të Vlorës, 1932). Sipas M. Belegut, ky ishte "aventurier" dhe "agjent i shteteve të huaja" (Mentar Belegu, "Kryengritja e armatosur e 14 gushtit 1935 në Fier, Mallakastër e në Skrapar", në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1982; Owen Pearson, *Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy 1908-1939*, London: I B Tauris Publishers 2004, f. 369. Çekrezi kishte përfituar nga amnistia e bërë nga mbreti Zog më 13 shkurt 1935.

* Kjo organizatë u themelua nga antizogistët ish oficerë si Ali Shefqet Shkupi, Ramiz Dibra, Ali Fehmi Kosturi, revolucionarë si Asim Vokshi, Mustafa Gjinishi, Zenel Hekali, Mustafa Kaçaçi dhe antizogistë të tjerë si Shefqet Vërlaci, Nuredin Vlora etj.

nëpunës aktivë, komandantë ushtrie e xhandarmërie etj⁷. Praktikisht, kjo organizatë paraqiste një lloj fronti forcash me një program në të cilin parashihej: rrëzimi i regjimit monarkik (Zogut), shpallja e republikës demokratike dhe abrogimi i të gjitha marrëveshjeve me Italinë⁸.

Sipas skenarit të organizatës në fjalë, lëvizja do të fillonte në qendrat e mëdha me atakimin e mbështetësve të regjimit, duke i neutralizuar përmes burgosjes apo dhe likuidimit të tyre dhe futjen në dorë të strukturave shtetërore. Fillimi i kësaj lëvizjeje do të duhej të përkonte me fazën e ndërhyrjes së armatosur të Italisë në Etiopi, sepse mendohej se Roma duke qenë e zënë me këtë fushatë do të hiqte dorë nga ndërhyrja në Shqipëri. Por pasi kjo organizatë mori informata se organet qeveritare i kishin rënë në gjurmë, u vendos që kryengritja të fillonte më 16 gusht⁹, që do të thotë se Dega e Fierit nxitoi dhe kështu komprometoi skenarin e organizatës. Degët e tjera të organizatës anë e kënd Shqipërisë dhe ajo në Tiranë që do të duhej ta luante rolin kryesor, nuk lëvizën. Organet shtetërore vepruan shpejt dhe në mënyrë efikase neutralizuan bazat e saj. Lëvizja e Fierit u shtyp dhe një pjesë e bartësve të saj u burgosën, ndërsa Çekrezi dhe Kranja me disa të tjerë¹⁰ ikën në Itali. Pasuan burgosjet dhe procesi gjyqësor ndaj pjesëmarrësve të lëvizjes si dhe ndërhyrjet e jashtme, asociacioneve ndërkombëtare¹¹ dhe përfaqësive diplomatike, në mbrojtje të të akuzuarve në emër të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Jehona e kësaj ngjarjeje në shtypin e kohës

Jehona e kësaj ngjarjeje jo vetëm në shtypin ballkanik po dhe atë evropian ishte shumë herë më e madhe sesa në rastet e ngjashme në Shqipëri e jashtë saj. Dukej sikur të gjithë e kishin pritur një lajm të tillë

⁷ Sipas shtypit jugosllav në këtë kryengritje kishim marrë pjesë të gjithë “arnautët e ikur nga Kosova”, (*Politika*, Beograd, 19 gusht 1935) si dhe Bedri Pejani dhe mjeku i nënës mbretëreshë Dr. Osmani (*Politika*, Beograd, 21 gusht 1935).

⁸ Për këtë shih te Mentar Belegu, *Kryengritja antizogiste e Fierit*, Universiteti i Tiranës “Enver Hoxha”, Tiranë: 1987.

⁹ *Historia e Popullit Shqiptar ..., vep e për., vëllimi III, f. 324.*

¹⁰ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), viti (më tej: V.) 1935, dosja (më tej: D.) 73, fl. 28-29, Bari, më 19 gusht 1935. Sheh Arapi - kryetar i Bashkësisë së Tepelenës, Zenel Hekali - mësues, Xhevahir Spatara - xhindarm. Ata të gjithë kishin deklaruar se ju vjen keq për humbjen.

¹¹ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë (1912-2000)*, Tiranë: Kristalina-KH, 2007, f. 194. Lidhja për të Drejtat e Njeriut në Paris dhe Këshilli i Lidhjes së Kombeve në Gjenevë.

nga Shqipëria. Më në fund në këtë vend po ndodhte “revolucionin” për të cilin nisi të shkruhej që në fund të vitit 1934¹². Kjo temë po vazhdonte të shtjellohej edhe pse së bashku me lajmin për “revolucionin” u mor dhe lajmi për shtypjen e tij. Shtypi jugosllav dhe ai grek po transmetonin idenë se Fieri s’ ishte veçse fillim i një revolucioni,¹³ i cili do të shtrihej në mbarë Shqipërinë. Dhe pikërisht shtypi i këtyre dy shteteve u bë pikë reference për shtypin gjithandej Evropës, madje dhe për atë britanik¹⁴.

Shqiptarët dhe shteti i tyre edhe njëherë u bënë objekt analizash dhe përfundimesh aspak të favorshme për ta. Një pjesë e shtypit iu rrek analizave që kishin të bënin me zbrëthimin e aspekteve konspirative në kuptimin se kush qëndronte prapa kësaj lëvizjeje, e cila shpërtheu pikërisht në kohën kur do të duhej të mbahej takimi i tre të mëdhenjve (Britani, Francë, Itali)¹⁵ dhe në kohën kur çështja e pushtimit të Abisinisë nga Italia ishte preokupim kryesor i diplomacisë dhe opinionit evropian e botëror.

Ndërsa, ka historianë që këtë ngjarje e kanë mbyllur brenda mureve shqiptare dhe konflikteve të brendshme për pushtet¹⁶, segmente të shtypit të kohës ngjarjen në fjalë e vendosnin brenda zhvillimeve rajonale dhe evropiane dhe e shihnin si pjesë të skenarëve ballkanikë dhe evropianë¹⁷. Shtypi frëng parapriu dhe vazhdoi me aktualizimin e Paktit italo-shqiptar të vitit 1926*, kurse ai britanik duke i bërë jehonë këtij të fundit po

¹² *Vardar*, (Shkup) 29 dhjetor 1934, f. 3. Kjo gazetë duke iu referuar informatave të “mbërritura nga Parisi” shkruante për stadin e zhvilluar (u mor pushteti) të një kryengritjeje me karakter “revolucionar dhe komplotist” në Shqipëri.

¹³ *Politika*, (Beograd) 17 gusht 1935, f. 1; *Politika*, 18 gusht 1935, f. 1; *Politika*, 21 gusht 1935, f. 2. Kjo gazetë beogradase i referohej shtypit grek dhe deklaratës së K. Tasit se kjo ngjarje është fillimi i një revolucioni të madh kundër regjimit në Tiranë.

¹⁴ *AMPJ*, V. 1935, D. 73, fl. 144-152. Pasqyra e shtypit britanik për ngjarjen.

¹⁵ Takimi i Parisit midis tri Fuqive në nivel ministror Idën, Laval, Aloizi i cili dështoi (*AMPJ*, V. 1935, D. 73, fl. 115, London, më 21 gusht 1935); *Politika*, 19 gusht 1935, i referohet shtypit grek konkretisht gazetës *Apogeomatini*, (Selanik) 18 gusht 1935.

¹⁶ I. Montaneli, *Shqipëria një dhe njëmijë ...*, f. 116. Ky autor konkludon se “këto lëvizje kryengritëse s’kanë prejardhje tjetër veç asaj të zhgënjimit të ambicieve personale”.

¹⁷ *AMPJ*, V. 1935, D. 73, fl. 144-151. Pasqyrë e shtypit britanik përgatitur për nevoja të MPJSH; *Apogeomatini*, (Selanik) 18 gusht 1935, aludonte se kjo ngjarje është skenar i politikave në nivel evropian për të “zhvendosur diskursin politik në Bazenin e Mesdheut”.

* Nga të gjithë artikujt lidhur me Shqipërinë në pranverën dhe verën e nxehtë politike evropiane të vitit 1935, ata të gazetarit të njohur frëng Zhendison, i cili preku pozitën

shtronte dhe trajtonte aspekte për mundësinë që Italia t'i drejtohej Ballkanit dhe po shpërfaqte prirjen për mundësinë e përfshirjes italiane në Shqipëri¹⁸. Në këta artikuj përveç emrit të Çekrezit u lakua dendur dhe emri i Gjilardit të vrarë, i Mbretit Zog e sidomos ai i Vërlacit si “dirigjues i kësaj ngjarje”^{*}.

Shtypi grek¹⁹, shkruante për dyshimin e “qarqeve zyrtare shqiptare” se prapa kësaj lëvizjeje qëndronte Italia dhe për frikën e tyre nga mundësia e ndërhyrjes italiane si rrjedhojë e synimit të Fuqive të Mëdha për kufizimin e synimeve të Italisë në Etiopi duke angazhuar atë në Shqipëri. Sipas këtij shtypi, në rast se realizohej ky skenar, Greqia kishte për detyrë që të ruante interesat e grekëve në shtetin shqiptar²⁰. Një paralajmërim ky për copëtimin e Shqipërisë. Ndërkaq shtypi turk, i cili në fillim ndoqi këtë linjë informatash, pas angazhimit zyrtar të Tiranës, hoqi dorë nga transmetimi i lajmeve të bazuara në shtypin jugosllav dhe grek, duke hedhur dyshim në vërtetësinë e informacioneve nga kryeqendrat e dy fqinjëve të Shqipërisë²¹. Prapa kësaj ngjarjeje dikush shihte gisht të Italisë²², dikush të Greqisë, dikush të Jugosllavisë, ndërsa shtypi gjerman shihte Britaninë e Madhe²³.

Shtypi më me pak peshë, si të thuash më i verdhë²⁴ duke pasur për mbështetje lajmin e rrejshëm të përsëritur me ngulm nga shtypi jugosllav

ndërkombëtare të Shqipërisë, jehuan aq shumë sa që në analet diplomatike del si “rasti Zhendison”.

¹⁸ AMPJ, V. 1935, D. 73, fl. 115-118, London, më 21 gusht 1935; *po aty*, fl. 144-151. Pasqyrë e shtypit britanik përgatitur për nevoja të MPJSH.

* Ky lajm i rremë ishte sajësë e propagandës jugosllave.

¹⁹ *Politika*, (Beograd) 18 gusht 1935, f. 1. Shtypi grek këtë lëvizje ia adresonte “njerëzve të Nolit”, siç bënte tradicionalisht në raste të ngjashme.

²⁰ *Politika*, (Beograd) 19 gusht 1935, f. 3. Komentonte shkrimin e gazetës *Apogeomatini*, të dalë në Selanik më 18 gusht.

²¹ AMPJ, V. 1935, D. 73, fl. 323, Istanbul, më 19 gusht 1935. Ky shtyp madje nisi të shprehte brengosje për faktin se Londra dhe Parisi (shtypi i tyre) po mbështetej në shtypin jugosllav dhe grek.

²² AMPJ, V. 1935, d. 73, fl. 113; Shtypi britanik duke u bazuar në informatat e siguruar nga personeli britanik në xhandarmërinë shqiptare shkruante se mendimi i përgjithshëm në Shqipëri ishte se prapa kësaj ngjarje qëndronte Italia.

²³ AJ, CPB (38-21-62), Albanija, “Les troubles albanais”; *Diplomatski Arhiv Saveznog Sekretariata Inostranij Poslova-Beograd* (më tej: DASSIP), Centralni Pres Biro (më tej: CPB), 1935. Përmbledhje artikujsh në baza mujore të shtypit botëror për Jugosllavinë dhe Ballkanin.

²⁴ AMPJ, V. 1935, D. 73, fl. 95.

sipas të cilit në krye të kësaj ngjarjeje qëndronte më i pasuri i Shqipërisë nga Elbasani, Shefqet Vërlaci, ngjarjen e paktoi si hakmarrje të një babai për poshtërimin e të bijës së tij të bukur të braktisur dikur nga i fejuari i saj, Ahmet Zogu²⁵. Madje, pati shkrime sipas së cilave edhe vetë vrasja e Gjilardit “nga Çekrezi” ishte bërë për arsye klasike nderi e jo arsye politike²⁶. Ekzotikë shqiptare, temë e preferuar evropiane.

Shtypi jugosllav për ngjarjen: paralajmërim për kthesën në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare

Shtypi jugosllav ishte më i zëshmi lidhur me këtë “ngjarje fatkeqe”, siç cilësohej “Kryengritja e Fierit” nga qarqet politike dhe mediale shqiptare. Shtypi në fjalë, kryesisht i përmbahej instruksioneve zyrtare të përpunuara në bazë të informatave dhe analizave të bëra nga përfaqësuesit zyrtarë jugosllavë në Shqipëri*. Këta të fundit në raportet e tyre nuk e fshihnin pezmin për dështimin e shpejtë të kësaj ndërmarrjeje të dhunshme për rrëzimin e Mbretit Zog dhe derdhnin lot krokodili për mënyrën e trajtimit të të burgosurve dhe pjesëmarrësve në këtë lëvizje²⁷. Madje, në shënjestër të tyre u gjet dhe Organizata për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut me qendër në Paris, e cila sipas këtij shtypi shpeshherë merrte në mbrojtje “persona të pa vlerë dhe të pamoralshëm”**, kurse nuk po protestonte ndërkohë që “qindra e qindra vriteshin dhe torturohen sepse ia donin të mirën vendit të tyre, dhe janë kundërshtar të një regjimi të “padurueshëm të disa gjakpirësve”²⁸. Nga Evropa kërkohet që më në fund t’i kushtojë më shumë kujdes këtij vendi “të revoltave dhe kryengritjeve të përhershme”²⁹. Megjithatë, aktori kryesor i kësaj ngjarjeje Çekrezi cilësohej si një person problematik, i cili në shumë komplete kishte “pasur rol të ndytë” dhe madje në rastin konkret “ndoshta i ka shërbyer regjimit si agjent provokator”³⁰. Shtypi

²⁵ *Po aty*, fl. 144-151. Pasqyrë e shtypit britanik përparuar për nevojat e MPJSH; *Tahidhromos*, (Greqi) 21 gusht 1935 etj.

²⁶ *Eleftheros Typos*, (Greqi) 22 gusht 1935.

* Lidhur me çështjen shih Fondin Centralni Pres Biro (CPB (32-21-62), Albanija, 1935), që ruhet në Arkivin e Jugosllavisë.

²⁷ *AJ*, CPB (32-21-62), Albanija, 1935, nr. 36.

** E kanë fjalën për oponencën politike kroate dhe bullgare ndaj regjimit jugosllav.

²⁸ *AJ*, CPB (38-21-62), Albanija, Beograd, 1 shtator 1935, ASHJ.

²⁹ *Po aty*.

³⁰ *Po aty*.

jugosllav “harroi” se para pak vitesh të njëjtin person e cilësonte si patriot e nacionalist të ndershëm, i cili ia donte të mirën Shqipërisë.

Në fakt në shkrimet e shtypit jugosllav theksi binte në “argumente” të cilët do të duhej të nënkuptonin skenaristin e vërtetë të kësaj ngjarjeje, Italinë: si Shefqet Vërlaci, i cili kishte reputacion të një italo-fili, ishte në krye të kësaj kryengritjeje³¹; Çekrezi dhe Kranja ikën në Itali me një barkë italiane “që i priste e gatshme”³²; Ngjarja u zhvillua në zonën e koncesioneve italiane; Përkrahja për rrëzimin e regjimit ka ardhur nga jashtë sikurse dhe ndihma financiare³³; Organizatën e Fshehtë e dekonspiroi Rudolf Lendreci³⁴ me qëndrim në Shqipëri, i cili ishte partizan i Paveliqit, e dihej se ky i fundit ishte i afërt me Musolinin; Pikërisht Lendreci, “ky agjent provokator” ishte dëshmitar në rastin e gjyqit të Fierit kundër “komplotistëve”. Atasheu jugosllav për shtyp në Tiranë Plamenac, kërkonte nga Pres Byroja jugosllave dhe kompetentët e tjerë në rrafshin e propagandës që të bëhej çmos që ky person të denigrohej moralisht para publikut të gjerë³⁵. Pohimet se Italia ishte prapa kësaj ngjarjeje po dhe dekonspiruese e saj, nga përfaqësuesit jugosllavë në Tiranë arsyetoheshin me konstatimin se qëllimi i vërtetë i “kësaj kryengritjeje” nuk ishte rrëzimi i “regjimit zogist” por “krijimi i një situatë të nderë me përmasa të mëdha e cila do të mund të shfrytëzohej për realizimin e qëllimeve të saj”³⁶.

³¹ *Politika*, (Beograd) 17, 18, 21 gusht 1935, f. 1; *Vardar*, (Shkup) 18 gusht 1935. Në fillim u shkrua se në krye të kësaj kryengritjeje qëndron Shefqet Vërlaci. Sipas kësaj gazete K. Tasi kishte deklaruar se kjo ngjarje është fillimi i një revolucioni të madh kundër regjimit në Tiranë.

³² *Politika*, (Beograd) 21 gusht 1935, f. 3; Në fakt kapitenin e barkës së gjetur aty rastësisht (në Karavasta) e detyruan me armë që të niset për Itali (*AMPJ*, V. 1935, D. 73, fl. 28, Bari, më 19 gusht 1935); O. Pearson, *Albanien and King Zog 1908-1939 ...*, f. 372.

³³ *Politika*, (Beograd) 20 gusht 1935, f. 3.

³⁴ *AJ*, CPB, 38-21-62, Albanija, nr. 116, 21 gusht 1935, ”Kryengritja në Fier”.

³⁵ Atasheu jugosllav për shtyp M. Plamenac në Tiranë, mendonte që duhej alarmuar e gjithë bota në favor të të përndjekurve. Ai e ndjeku gjyqin e Fierit me lejen e Musa Jukës dhe shënon se të burgosurit ishin torturuar madje dhe Shefqet Ali 60 vjeçar. “Të gjithë ishin në pranga përveç Qemal bej Vrionit dhe simpatikut Nuredin bej Vlorës që kishin duar të lira”, - shkruan ai. (*AJ*, CPB (38-21-62), Albanija, 1935, nr. 36). Ky atashe njëkohësisht propozon që të ndihmohen avokatët e të dënuarve të Fierit.

³⁶ *Arhiv Vojno-Istorijskog Instituta* (më tej: *AVII*), P-17, K-27, f. 2, nr. 316, 18 shtator 1935.

Shtypi jugosllav nuk ndalej përkundër faktit që legata shqiptare në Beograd i përgënjeshtroi të gjitha këto shkrime duke i quajtur tendencioze dhe qëllimkëqija³⁷. Procesi gjyqësor dhe dënimet e pjesëmarrësve në ngjarjen e Fierit shënuan kulmin e duelit të ashpër midis shtypit të dy vendeve fqinjë. Gazeta gjysmëzyrtare shqiptare *Besa* e akuzonte shtypin jugosllav për sjellje jokorrekte madje dhe për shpifje. Sipas kësaj gazete, shtypi jugosllav po luante rolin e avokatit të pandjenja, i cili kur ballafaqohet me faktin se “klienti i tij është fajtor, shërbehet me shpifje për të hutuar drejtësinë ...”³⁸. Duke bërë vështrimin e shkrimeve në gazetën gjysmëzyrtare beogradase *Politika* lidhur me torturat që po bëheshin nëpër burgjet e Shqipërisë, *Besa* ironizonte se mbase këso lloj torturash “*Politika* i ka parë në vendin e saj, të përdorura për të siguruar “bashkimin kombëtar”³⁹. “Ngjarja e Fierit na tregoi se kemi armiq, të cilët nuk zgjedhin mjete për të na diskredituar edhe si shtet edhe si komb”⁴⁰, konstatonte kjo gazetë shqiptare. Për t’i dalë përpara propagandës së huaj e në radhë të parë asaj jugosllave, në Tiranë u shtrua nevoja imediate për një gazetë në gjuhë të huaj, për lidhje telefonike me “shtetet e jashtme” dhe për një radiostacion⁴¹.

Tensionimi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave

Kryqëzimi i shpatave Beograd-Tiranë në rrafshin mediatik në fakt paralajmëronte kthesën negative në marrëdhëniet midis dy vendeve fqinjë. Akordimi i plotë i shtypit dhe i diplomacisë jugosllave lidhur me ngjarjen e Fierit vërehet në shkresën zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme jugosllave drejtuar përfaqësive jugosllave gjithandej Evropës. Sipas kësaj ministrie, kjo lëvizje ishte e organizuar nga “bejlerët e pakënaqur” të përkrahur nga Italia dhe ky konstatim arsyetohej me fakte rrethanore si: aktiviteti i kryengritjes u përqendrua në viset ku kishte më së shumti koncesione italiane; në krye të saj ishte K. Çekrezi-një italoofil i

³⁷ *Politika*, (Beograd) 17 gusht 1935, f. 1; *Vardar*, (Shkup) 18 gusht 1935, f. 3. Sipas deklaratës zyrtare shqiptare “një grup agjitorësh ka pasur për qëllim të bëjë çrregullime me qëllime të caktuara, e në rend të parë për të cenuar prestigjin e Shqipërisë”.

³⁸ *Besa*, (Tiranë) 20 shtator 1935.

³⁹ *Po aty*.

⁴⁰ *Besa*, (Tiranë) 27 shtator 1935.

⁴¹ *AMPJ*, V. 1935, D. 73, fl. 116, London, 21 gusht 1935; *Besa*, (Tiranë) 27 shtator 1935.

madh para shtëpisë të së cilit “çdo ditë mund të shihej agjenti italian Montanari” dhe fakti që udhëheqësit e kryengritjes ikën nga “Sazani në Bari-Itali”⁴².

Për Tiranën zyrtare përfundimisht po qartësohej fakti se qeveria e re jugosllave me në krye Stojadinoviçin (korrik 1935), po hiqte dorë nga politika e afrimit dhe bashkëpunimit fqinjësor të promovuar që nga fundi i vitit 1933⁴³. Angazhimi demonstrativ i ministrit fuqiplotë jugosllav në Tiranë Gjonoviç, me rastin e procesit gjyqësor të pjesëmarrësve në Lëvizjen e Fierit dhe anëtarëve të Organizatës së Fshehtë, shpërfaqti plotësisht këtë trend politik. Ky doli hapur në mbrojtje të të akuzuarve për këtë ngjarje. Me rastin e shqiptimit të dënimeve, Gjonoviç mori rolin e të parit të korit diplomatik dhe më 11 shtator 1935 në legatën jugosllave, mbledhi përfaqësuesit e huaj në Shqipëri. Në këtë tubim, ministri fuqiplotë jugosllav shtroi nevojën që të bëhej një ndërhyrje kolektive tek autoritetet shqiptare në mënyrë që të “shpëtojnë jetë të njerëzve të pafajshëm” dhe të viktimizuar⁴⁴. Sipas tij, ky angazhim do të ishte në interes të Shqipërisë dhe vetë regjimit, autoriteti i të cilit po dobësohej gjithnjë e më shumë, sepse “Shqipëria e Zogut, kështu siç është nuk mund të jetë faktor paqeje dhe rendi në të ardhmen e afërt”⁴⁵. Aludimi ishte i qartë. Shqipëria mund të instrumentalizohej nga Italia po dhe të humbiste pavarësinë e saj. Njëkohësisht, ky demonstrim kishte dhe kuptimin e porosisë së qartë drejtuar Mbretit Zog për faktin se Beogradi refuzon synimet dhe përpjekjet shqiptare për partneritet e bashkëpunim. Në këtë mënyrë, nga pozita e të akuzuarit si skenarist i kësaj ngjarjeje Beogradi kaloi në pozitën e akuzuesit, duke përcjellë mesazhin se përkundër angazhimit të tij për një Shqipëri të pavarur dhe të qëndrueshme, ky “dështak ballkanik”^{*} gjithnjë po gjallonte si thembër akili për Ballkanin. Në fakt, qeveria e re jugosllave, përmes këtij diskursi agresiv ndaj Shqipërisë po promovonte një politikë të re me qëllim

⁴² Živko Avramovski, “Prilog pitanju istorije Albanije u periodu izmedju dva svetska rata”, në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 3, Prishtinë: 1966.

⁴³ Për këtë shih E. Arifi-Bakalli, *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929-1939*, Instituti i Historisë së Kosovës, 1997 Prishtinë.

⁴⁴ *AJ*, CPB (38-21-62), Albanija, nr. 134, Tiranë, më 11 shtator 1935. Gjonoviç shtroi kërkesën që të gjithë ata të kërkojnë nga qeveritë e tyre për të marrë leje për hapa pranë qeverisë shqiptare.

⁴⁵ *Po aty*.

* Një sintagmë e preferuar për Shqipërinë në zhargonin politik jugosllav.

faktorizimi të Jugosllavisë në rrjedhat e politikave të mëdha ndërkombëtare sidomos në relacion me Italinë po dhe me Gjermaninë.

Natyrisht ky qëndrim i Beogradit bëri që edhe pala shqiptare të flasë hapur me atë jugosllave. Ministri Fuqiplotë shqiptar në Beograd Rauf Fico, në dy takimet që pati në Ministrinë e Punëve të Jashtme jugosllave, të parin (më 30 shtator 1935) me sekretarin e Përgjithshëm të kësaj ministrie Martinac⁴⁶ dhe pas një jave me vetë kryeministrin Stojadinoviç, radhiti argumentet përse në Tiranë ishte krijuar përshtypja për rolin aktiv të Beogradit në këtë ngjarje, si: pjesëmarrja në këtë ngjarje e Çekrezit dhe disa të tjerëve që “shumë vjet u subvencionuan nga legata jugosllave”; mënyra e trajtimit të kësaj ngjarjeje në shtypin jugosllav dhe “shpifjet e gazetës *Politika*”; të veçuarit e legatës jugosllave nga pjesëmarrja në funeralin e gjeneral Gjilardit, e në të cilin kishin marrë pjesë të gjithë diplomatët e tjerë⁴⁷. Sado që Fico u kujdes që këto argumente të paktoheshin si mendime “të disa rretheve” dhe nuk mund të konsideroheshin si mendime zyrtare të qeverisë mbretërore shqiptare, sipas tij, kryeministri jugosllav u gjet “mjaft i prekur”. Ai kishte shprehur pakënaqësinë për aludimet që po bëheshin në Tiranë për “gjoja ndihmën jugosllave dhënë kryengritësve” dhe që “lojaliteti” jugosllav po trajtohej në atë mënyrë, pasi që “ishte në interes të Jugosllavisë, një Shqipëri e stabilizuar dhe e fortë”. “Për çfarë arsye dhe për kë do të duam ngatërresa në Shqipëri?”- pyeti Stojadinoviç, duke mohuar kategorikisht se Çekrezi gëzonte përkrahje nga Beogradi. Pas insistimit të Ficos ministri i Jashtëm jugosllav u tërhoq duke pohuar që kjo përkrahje nuk ishte bërë nga “qeveria e tij”⁴⁸. Përkundër përgënjeshtimeve nga Beogradi, jugosllavët konstatonin se megjithatë faktorët zyrtarë shqiptarë për këtë ngjarje në radhë të parë fajësonin Jugosllavinë⁴⁹. Nga qëndrimi i palës shqiptare dilte porosia e qartë për Beogradin: ju nuk jeni të gatshëm që të merrni përgjegjësi rajonale në përputhshmëri me fuqinë tuaj reale dhe po na detyroni që të gjejmë rrugë mbijetese jashtë këtij rajoni.

Cili ishte roli i Jugosllavisë në këtë ngjarje?

Historiografia shqiptare prapa “Kryengritjes së Fierit” ka parë nëntokën italiane dhe atë jugosllave dhe njëkohësisht ka evidencuar se

⁴⁶ *AMPJ*, V. 1935, D. 141, nr. 17, Beograd, më 30 shtator 1935

⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁸ *AMPJ*, V. 1935, D. 141, nr. 14, Beograd, më 7 tetor 1935.

⁴⁹ *AVII*, P-17, K-4, nr. 3914.

legata jugosllave në Tiranë e informuar nga agjenti i saj në Organizatën e Fshehtë i kishte paralajmëruar zyrtarët shqiptarë për fillimin e kësaj lëvizjeje⁵⁰. Por sa qëndron ky konstatim? Nga burimet jugosllave⁵¹ del se përfaqësuesit jugosllavë në Shqipëri nuk kishin asnjë informacion për kohën e fillimit të kësaj kryengritjeje. Një komunikim i dokumentuar midis Shtabit Madhor jugosllav dhe përfaqësuesit të saj në Shqipëri e ilustron qartë konkluzionin e mësipërm. Kjo Shtatmadhori e qortoi atasheun ushtarak jugosllav në Shqipëri, për faktin se ai jo vetëm që nuk kishte pasur asnjë informacion për mundësinë e çrregullimeve dhe të ndonjë kryengritjeje e “të cilat paraqesin objekt të rëndësishëm të interesimeve tona”, po aq më keq ai pikërisht në prag të ngjarjes së Fierit kishte kërkuar një pushim, madje të gjatë⁵². Të dhënat që jep atasheu në fjalë si përgjigje ndaj këtij qortimi janë me rëndësi të madhe për të plotësuar mozaikun lidhur me çështjen në fjalë. Atasheu ushtarak jugosllav konstaton se në Shqipëri si pasojë e kushteve jashtëzakonisht të pavolitshme, madje “të padurueshme” ka shumë të pakënaqur, prandaj është lehtë të shpërthejnë kryengritjet e sidomos kur ato “nxiten nga jashtë” [aludon për Italinë]. Sipas tij, organizimi i kryengritjes ishte bërë me shumë kujdes dhe në fshehtësi të madhe dhe se për vendin, qëllimet dhe kohën e kryengritjes nuk kanë pasur njohuri as autoritetet shqiptare⁵³. Aq më pak kanë ditur përfaqësuesit e shteteve të jashtme, ata të cilët nuk kanë pasur gisht “në organizimin e kryengritjes”⁵⁴ dhe së fundi konstatimi se “as ministri ynë fuqiplotë (Gjonoviq-E. B.) nuk ka ditur asgjë për këtë kryengritje, deri në ditën e shpërthimit të saj...”⁵⁵.

Por kjo nuk do të thotë se jugosllavët nuk ishin në dijeni për vetë Organizatën e Fshehtë dhe synimet e saj politike. Shërbimi informativ ushtarak jugosllav për organizatën në fjalë kishte informata që nga fundi i

⁵⁰ *Historia e Popullit Shqiptar...*, vep. e përm., vëll. III, f. 324

⁵¹ AVII, P-17, K-27, F-4, nr. 3914. Atasheu ushtarak jugosllav në Tiranë ishte krejt i sigurt që këtë kryengritje e kishin organizuar italianët madje “me mjeshtri të madhe ...”.

⁵² AVII, P-17, K-27, F-2, nr. 316, 19 gusht 1935.

⁵³ Supozojmë që ky informacion ka të bëjë me faktin që Beogradi e ka pasur informatorin e tij në rrethet e politikës sipërore shqiptare. Kjo e dhënë gjendet në elaboratin “Shqipëria midis dy luftërave” që ruhet në Arkivin e Institutit Ushtarak në Beograd. (AVII, P-17, K-61g, f. 1, d. 14).

⁵⁴ AVII, P-17, K-27, F. 2, nr. 316, 18 shtator 1935. Sipas këtij burimi gati të gjithë përfaqësuesit e huaj në Shqipëri në këtë kohë kishin marrë pushimin 2 mujor.

⁵⁵ *Po aty*.

vitit 1934. Burim informimi ishte A. Lleshi, i cili e kishte “njeriun e vet në shërbim të Shefqet Vërlacit”, e sipas të cilit kjo lëvizje gëzonte përkrahje materiale nga Italia⁵⁶. Pak më vonë, edhe atasheu ushtarak jugosllav në Tiranë u informua për ekzistimin e kësaj organizate nga “personi i cili nuk punon për para”⁵⁷, e ky ishte Ramiz Dibra njëri ndër themeluesit e Organizatës së Fshehtë, tek i cili atasheu në fjalë banonte dhe me të njëjtin kishte “lidhje shumë të mira miqësore”. Madje, në janar 1935, R. Dibra kishte bërë sondazhe lidhur me pozitën e dibranëve të “tij” në rast se aksioni i tyre kundër mbretit do të përfundonte pa sukses. Me fjalë të tjera, ai ishte i interesuar të dinte a do të gëzonin ata mikpritjen jugosllave në rast të dështimit, apo ndoshta e kundërta do t’u mbyllej kufiri?⁵⁸. Ky interesim i Dibrës duket se më shumë ka të bëjë me prekjen e pulsit jugosllav, në rastin konkret të qarqeve ushtarake atje, lidhur me aksionin e tyre për rrëzimin e Mbretit Zog, në kohën kur ende mendohej se marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave vazhdonin të ishin miqësore.

Pra, jugosllavët ishin në dijeni të qëllimeve të Organizatës së Fshehtë antizogiste dhe mundësisë së një lëvizjeje të gjerë, e cila mund të çonte deri te ndonjë kthesë rrënjësore në krye të Shqipërisë⁵⁹. Duke u nisur nga kjo dhe duke e ditur predispozitën e kryeministrit të ri, Stojadinoviq ndaj Shqipërisë, Gjonoviq pa vonesë kishte përgatitur një plan veprimi për realizimin e synimeve të Beogradit ndaj këtij shteti fqinj^{*}. Në memoaret e tij Stojadinoviq nënvizon se më 4 korrik 1935, Gjonoviq të cilin e cilëson si një ndër diplomatët më të shquar jugosllavë, i kishte dërguar atij një shkresë në të cilën kishte bërë një plan të përpiktë dhe shumë interesant, sipas të cilit “çështja shqiptare” mund të zgjidhej në favor të Jugosllavisë. Sipas mendimit të Gjonoviqit, tani kur Italia ishte angazhuar në Abisini, duhej të shfrytëzohej rasti në mënyrë që çështja shqiptare të hiqej nga rendi i ditës qoftë përgjithmonë, qoftë për një kohë të gjatë^{**}.

⁵⁶ AVII, P-17, K-27, F. 2 nr. 12, 4 dhjetor 1934.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ AVII, P-17, K-27, F. 2 nr. 34, 29 janar 1935, Atasheu ushtarak jugosllav në Shqipëri.

⁵⁹ Po aty.

* Ky plan veprimi nuk përmendet as nga autorë jugosllavë e as të huaj dhe as unë nuk kam hasur në një të tillë në dokumentet arkivore jugosllave.

** Opsioni i zgjidhjes definitive të “çështjes së Shqipërisë” pra “përgjithmonë” i Beogradit ka nënkuptuar eliminimin e shtetit shqiptar, ndërsa opsioni i zgjidhjes “për një kohë të gjatë” ka nënkuptuar instalimin e një regjimi marionetë të tij.

Stojadinoviçi në memoaret e tij shpreh keqardhje që përkundër dëshirës së madhe, në atë moment nuk kishte pasur mundësi t’i kushtojë vëmendjen e duhur kësaj çështjeje, ngase kishte qenë i angazhuar në politikën e brendshme të Jugosllavisë⁶⁰.

E megjithatë diplomacia jugosllave me shumë kujdes po e hetonte predispozitën e të mëdhenjve lidhur me Shqipërinë. Marrëveshja italo-frënge e janarit 1935⁶¹ dhe në përgjithësi shtypi frëng e bënte të qartë qëndrimin e Francës ndaj Shqipërisë. Kjo e fundit shihej si sferë e interesit italian. Ky trend në politikën e Parisit dhe mendimi që po krijohej sipas të cilit Italia mund t’ia mësynte Shqipërisë me përkrahjen nga kjo anë, bëri që Britania e Madhe të perceptohej si mbrojtësja e vetme e *status quo*-së në Ballkan. Prandaj, më 19 gusht 1935, Stojadinoviçi në notën drejtuar Forin Ofisit shpërfaqte interesimin e Jugosllavisë që pavarësia e Shqipërisë duhej ruajtur sepse kjo ishte në interes të paqes në Ballkan dhe në Evropë⁶². Ndërkaq, më 25 gusht, ministri Fuçplotë jugosllav në Romë Duçiq çështjen e “situatës në Shqipëri” e diskutoi me diplomatin britanik-Drumond. Ky i fundit “ndoshta rastësisht” e pyeti Duçiqin “Çka thoni që Shqipërisë t’i jepej një regjim neutral siç e ka pasur Belgjika para vitit 1914?”. Nga kjo bisedë, Duçiq nxirrte përfundimin se, “tani kur diheshin synimet italiane në Mesdhe, Britania kishte filluar të interesohej më shumë për Shqipërinë në duar të së cilës ishte Vlora, çelësi i Adriatikut”⁶³.

Sondazhi në Londër

Edhe diplomacia shqiptare sytë i ktheu drejt Londrës. Për të trajtuar çështjen e ditës dhe aspekte të “tjera delikate” me kompetentët e Forin Ofisit, Tirana e autorizoi diplomatin e saj, Fuad Asllanin si të dërguar të jashtëzakonshëm dhe ministër Fuçplotë në Londër. Ai pati disa takime me përgjegjësit e Seksionit të Evropës Juglindore të Forin Ofisit me ç’rast shpërfaqti shqetësimet e Tiranës lidhur me pozicionimin e shtypit britanik ndaj atij frëng, i cili tashmë siç ishte gazeta me peshë “Le

⁶⁰ M. Stojadinovic, *N i rat ni pakt (Jugoslavija izmedju dva rata)*, “Otokar Kresovani”, Rijeka: 1970, 421-422.

⁶¹ *Historija diplomacije, v. III*, Matica Hrvatska, Zagreb: 1951.

⁶² V. Vinaver, “Anglia dhe pozita ...”, pun. i përm., f. 230.

⁶³ *DASSIP*, Londonsko Poslanstvo (më tej: LP), 1935, F-I, nr. 719, Romë, më 25 gusht 1935.

Temps⁶⁴ po shfaqte “italofili”, duke aktualizuar tema të ndjeshme lidhur me statusin ndërkombëtar të Shqipërisë, e sidomos analizat shqetësuese lidhur me mundësinë e ndonjë intervencioni të Italisë në Shqipëri në frymën e Paktit të Parë të Tiranës. “Kuptojmë situatën tuaj dhe shpjegimet që na jepni. Komentimet e “Temps-it” nuk sjellin asnjë ndryshim në pikëpamjen dhe qëndrimin tonë⁶⁵ - kishte deklaruar – diplomati britanik Carr.

Në fakt, nuk ishte fjala vetëm te kjo gazetë prestigjioze franceze dhe “italofilia” e saj. Çështja ishte te qëndrimi i qarqeve zyrtare franceze në këtë rast dhe fakti që gazeta të njohura britanike po bartnin komentet e kësaj gazete. Carr pranoi se kishte një fushatë lidhur me Shqipërinë, duke konstatuar se shkrimet e shtypit të huaj për këtë ngjarje (Fierin-E.B.) ishin “të turpshme, imorale dhe të shëmtuara” dhe se shtypi britanik nuk ishte një rast i tillë. Madje sipas Asllanit, Carr tregoi gatishmëri që Forin Ofisi informatat nga Zyra e shtypit shqiptar për ngjarjet në Shqipëri t’i vejë në dispozicion të shtypit britanik në rast se nga kjo anë kërkohej ndonjë “shpjegim⁶⁶”.

Përveç kësaj, Tirana ishte e interesuar që Forin Ofisit t’i bëhej me dije se ajo nuk e kishte pritur mirë ndërhyrjen e shteteve të jashtme për zbutje dënimesh të të burgosurve. Zbutja e dënimeve që sigurisht do të ndodhte nuk kishte të bënte me kërkesat e askujt nga jashtë “po për arsye të tjera të pavarura prej kësaj dhe sepse mëshira del vetvetiu nga ndjenjat bujare⁶⁷ të Mbretit Zog. Asllani me këtë rast kishte theksuar se përkundër faktit që Shqipëria ishte shtet i vogël, ajo nuk do të pranonte t’i cenohet “as prestigji dhe as liria e veprimit”, sidomos kur bëhet fjalë për sigurinë e brendshme dhe të jashtme të saj. Kjo çështje po shtrohej me Britaninë sepse Tirana kishte besim në qëllimin e mirë të saj. Dhe më kryesorja, Tirana ia bënte me dije Londrës se Lëvizja e Fierit nuk kishte të bëjë vetëm me pakënaqësitë nga ana e pjesëmarrësve në këtë lëvizje

⁶⁴ *Le Temps*, (Londër) 19 gusht 1935. Në artikullin “L’agitation en Albanie” ishte trajtuar dhe interpretuar Traktati shqiptaro-italian i vitit 1926 që nënkuptonte intervencionin italian në rast rreziku për Shqipërinë (*AMPJ*, V. 1935, D. 73, fl. 115-119, raport nga Londra, 22 gusht 1935). Carr duke komentuar shkrimet e shtypit deklaroi se “... nuk duhesh përdorur argumente futille (të parëndësishme-E.B.) kësodore për të influencuar opinionin publik për të ndaluar luftën midis Italisë dhe Abisinisë”.

⁶⁵ *AMPJ*, V. 1935, D. 73, fl. 117, London, më 21 gusht 1935.

⁶⁶ *Po aty*.

⁶⁷ *Po aty*, fl. 124-128, Tiranë, më 21 shtator 1935.

por dhe shkaqe të tjera “edhe më të rënda si shtytje nga jashtë me qëllime t’errta politike”⁶⁸ kundër pavarësisë së Shqipërisë dhe diskreditimin e saj. Carr u falënderua për besimin dhe përjashtimin që po i bëhej Britanisë së Madhe në këtë rast. Asllani konstatonte se Londra ishte tej mase e ngarkuar me çështje qenësore (Gjermania, Egjipti, Etiopia), të cilat çështje kërkonin shqyrtim dhe miratim në nivel kombëtar. Në Forin Ofis po bëheshin konsultime edhe me përfaqësuesit e opozitës si dhe ish burra shteti si Ll. Xhorxh e të tjerë⁶⁹, siç veprohej në situatat e jashtëzakonshme. E megjithatë shtypi britanik e trajtoi çështjen e dënimeve të shqiptuara për pjesëmarrësit në ngjarjen e Fierit. Në këtë shtyp evidencohej, natyrisht dhe kundërshtohej “përndjekja e familjes Vlora” duke marrë si shembull dënimin e Nuredin Bej Vlorës⁷⁰.

Përmbyllje

Përmasat e reagimit në sensin negativ në shtypin jugosllav, në analizat e një segmenti nëpunësish diplomatikë të këtij shteti për ngjarjen e Fierit dhe procesin e dënimit të pjesëmarrësve në të, morën karakter të një fushate kundër kreut shtetëror shqiptar. E gjithë kjo si dhe sjellja demonstrative e ministrit Fuqplotë jugosllav Gjonoviq, mund të shpjegohen edhe si shpërthim i dhunës shpirtërore të përjetuar nga zyrtarë jugosllav gjatë kohës kur kreu qeveritar jugosllav praktikonte diskurs të relaksuar dhe madje paqësor ndaj Shqipërisë dhe kreut të saj (fundi 1933-gjysma e parë 1935). Ngjarja e Fierit përkatësisht acarimi i marrëdhënieve Beograd-Tiranë që e përcolli dhe e përmbylli këtë ngjarje, e ktheu Beogradin në kornizat e rëndomta të botëkuptimeve dhe misionit të tij ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve⁷¹. Ngjarja e Fierit u bë shkas i braktisjes së iluzionit për marrëdhënie miqësore midis Tiranës dhe Beogradit. Ato sërish u kthyen brenda një standardi, i cili nënkuptonte ftohje të tyre deri në acarim.

⁶⁸ *Po aty*, fl. 124-128. Londra duhej të informohej se jo të gjithë xhandarët patën fatin e 11 të ekzekutuarve. Ata që nuk u larguan nga Fieri nuk e pësuan këtë dënim ... por vetëm ata më të vendosurit që marshuan drejt Lushnjës ...

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ *The Times*, (Londër) 26 nëntor 1935; *AMPJ*, V. 1935, D. 95, f. 96, Londër, më 30 nëntor 1935. (Kryesi i Detyrës shqiptar - Ç. Saraçi): ky si dhe të tjerë u amnistua me rastin e përvjetorit të Pavarësisë, 28 nëntor 1935.

⁷¹ Ujdia Çiano-Stojadinoviq në Belje janar 1939 për eliminimin dhe copëtimin e Shqipërisë; Konventa jugosllavo-turke për shpërngulje korrik 1938, e cila parashihte shpërnguljen masive të shqiptarëve nga Jugosllavia në Turqi.

Pa marrë parasysh shkallën e rolit të faktorit të jashtëm në këtë lëvizje politike në Shqipëri në veçanti atë të Jugosllavisë dhe Italisë, nga kjo analizë del se të gjithë si në planin rajonal ashtu dhe në atë evropian kontribuuan që Shqipëria dhe shqiptarët të bëhen temë për një kohë të gjatë. Në këtë kontekst nuk duhen anashkaluar edhe zërat që u dëgjuan në shtypin evropian për interesin e Fuqive të Mëdha që të mjegullojnë pushtimin e Etiopisë me një ngjarje në Evropë e cila mund të rrezikonte paqen e përgjithshme evropiane. Jo rastësisht, shtypi frëng dhe ai britanik duke iu referuar këtij të parit, po shtronte dhe trajtonte tema delikate lidhur me statusin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe mundësinë e përfshirjes italiane në këtë vend. Aktualizimi i një Pakti të skaduar që në vitin 1931 (Paktit të Parë të Tiranës, 1926) në kohën kur Tirana zyrtare po demonstronte qëndrueshmëri në rrugën e saj për emancipim⁷², ishte tregues i fillimit të politikave mbijetuese në plan të gjerë, në themelet e së cilës përherë flijohen të vegjlit, çfarë ishte shteti shqiptar. E mbetur në udhëkryq, pa asnjë iluzion që mund të gjente përkrahje nga Jugosllavia, nga Pakti Ballkanik apo dhe që të mund të siguronte ndonjë përkrahje financiare nga çfarëdo burimi, Tirana sërish sikurse në vitin 1926 u detyrua që të afrohet me Romën.

S u m m a r y

“THE FIERI UPRISING” AS A REASON FOR THE NEGATIVE TURN IN THE ALBANIAN-YUGOSLAV RELATIONS

The so called “Fieri Uprising” of August 1935 in Albania and especially its epilogue – the trial of its instigators and participants put this Balkan state in the focus of the press and of the diplomacy of the time. Both were of the opinion that this event would have an impact outside the Albania’s national borders and even outside of the region. Irrespectively of who were the instigators, this event caused tension in the Albanian-Yugoslav relations, which had been on very good footing since when the mutual negotiations (in the

⁷² Për këtë shih Emine Bakalli, “Politika emancipuese e Shqipërisë gjatë viteve 1929-1935”, në *100 vjet Pavarësi, Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare*, Tiranë, 26-27 nëntor 2012, vëll. II, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2014, f. 59-72.

second half of 1933 – first half of 1934) on the Supplementary Agreement to the Treaty of Commerce and Navigation of 1926 and others of the same character had begun. The new Yugoslav government headed by the Prime Minister Milan Stojadinovic took this opportunity to accuse Albania of inciting repressive home policies and of undertaking foreign policies disturbing the stability of the region. Through this campaign Belgrade aimed at labeling Albania as an unstable country, and tried to avoid engaging in mutual agreements.

Meanwhile, faced with fact that Belgrade was returning to its traditional attitude towards Albania, Tirana replied by accusing Yugoslavia of providing support for the instigators and the Albanian political emigrants in order to destabilize this country. Deeply disappointed from the lack of any kind of economic or political foreign support (from Yugoslavia, the Balkan Pact, the western democracies, the League of Nations, etc.), and devastated by the economic depression, Albania took the only road left in order to ensure its survival, the one that led to Rome.

